



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:011553

Datë: 25.09.2024

Numri i dokumentit: 06209806

C-III- 15 – 1077

Paditës : KB S Prishtina.

Kundër

Të paditurës : Qendra Sportive Kulturere dhe Ekonomike „Pallati i Rinis ” Prishtinë .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me 24 shtator 2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës shpallet, jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur, sipas kërkesës së paditësve për kompensimin e dëmit material si pasoj e shkaktimit të zjarrit .**
- II. Padia dhe shkresat e lëndës, ti dërgohen në vendosje Gjykatës Komerciale në Prishtinë, si kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur për kërkesën e paditësve .**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 08.12.2006, paditësi ka ushtruar padi, në Gjykatën Komunale në Prishtinë C. nr. 2575/06, kundër të paditurit për kompensim dëmi për shkak të mos përmbushjes së kontratës në lidhje me shfrytëzimin e hapësirës – sallës së vogël, për stërvitje apo organizim të ndeshjeve .

Më dt. 16.05.2012, Gjykata Komunale në Prishtinë, është shpallur jo kompetente dhe rasti është dërguar në DHPGJS.

Më dt. 01.09.2016, DHPGJS ka marre aktvendim C- III- 1077, me të cilin ka pezulluar procedurën për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit të në NSH Qendra Sportive Kulturere dhe Ekonomike „Pallati i Rinis ” Prishtinë.

Në ndërkohë Agjencia Kosovare e Privatizimit, e ka njoftuar Dhomën e Posaçme se kjo NSH nuk është më në administrim të Agjencisë, por është si Ndërmarrje Publike .

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është me kompetencë lëndore për të vendosur në lidhje me padinë e paditësit, kundër të paditurve .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, ka juridiksion për të vendosur në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 06/L-086 Për DHPGJSK Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për Ndërmarrjet apo Korporatat të cilat i nënshtrohen autoritetit administrativ të AKP-së .

Me vendimin e Qeveris së Republikës së Kosovës nr. 07/21, të datës 22.12.2017, si dhe me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës 06-V-080, dt. 15.03.2017, është vendosur ti hiqet kompetenca ligjore e AKP-së, ndaj NSH Qendra Sportive, Shoqërore, Kulturere dhe Ekonomike „Pallati i Rinisë ” në Prishtinë dhe kjo ndërmarrje dhe asetet e saj të regjistruhen si Ndërmarrje Publike Lokale.

Meqenëse të paditurës ju ka ndryshuar statusi i saj , ajo nuk është nën administrimin e AKP-së, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur në lidhje me kërkesëpadinë e paditësve, për kompensim dëmi për mos përmbushje të kontratës.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme vlerëson se për rastin konkret si kompetente për të vendosur, është. Gjykata Komerciale në Prishtinë sipas nenit 4, paragrafi 1, të Ligjit nr. 08/L-015 .

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë, me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh, nga pranimi i këtij aktvendimi.

Hasim Sogojeva
Gjyqtar